



PROGRAMI PËR VETËPUNËSIM

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR SIPËRMARRËSI
DHE ZHVILLIM TË AFTËSIVE TË BIZNESIT



#ShansPërTëGjithë

#ShansPërTëGjithë

Përmbajtja

| | |
|---|-------|
| Për këtë edicion | 05 |
| Rendi i ditës i trajnimit | 6-8 |
| Hyrje | 10-11 |
| MODULI 1: Sipërmarrësia | 12-23 |
| MODULI 2: Digjitalizimi i proceseve të biznesit | 25-28 |
| MODULI 3: Bazat e biznesit | 32-35 |
| MODULI 4: Plani i marketingut | 39-42 |
| MODULI 5: Shitja | 49-50 |
| MODULI 6: Plani i prodhimit dhe shërbimit | 53-54 |
| MODULI 7: Financat | 59-61 |
| MODULI 8: Plani investues | 67 |
| • Plani i organizimit dhe menaxhmentit | 72 |
| • Tatimimi | 74 |
| Përshkrimi i idesë së biznesit | 77 |
| • Pyetëtori për evaluim | 89 |



Për këtë edicion:

Të nderuar sipërmarrës të ardhshëm,

Fillimi dhe menaxhimi i biznesit të suksesshëm personal, nuk është fare i lehtë dhe as i thjeshtë.

Duke jetuar në një botë e cila ndryshon në mënyrë turbulente, ndërkohë që informacionet, idetë dhe njohuritë lëvizin me një shpejtësi marramendëse, ndryshojnë dhe bashkëndahen, vendimi për themelimin e firmës personale nënkupton shumë guxim, njohuri, aftësi, por edhe gatishmëri për avancimin e vazhdueshëm, ndjekjen e tendencave botërore dhe modeleve të suksesshme të biznesit, analizën e konkurrencës, si dhe mbështetjen nga të afërmit dhe mjedisi.

Duke u udhëhequr pikërisht nga këto premisa, në këtë edicion do të keni mundësi ta shqyrtoni materialin në kuadër të Programit të trajnimit për sipërmarrësi dhe zhvillimin e aftësive të biznesit, i organizuar në kuadër të Programit për vetëpunësim.

I organizuar në 7 tërësi tematike, ose në 7 module të fokusuar mbi bazat e sipërmarrësisë, ky Manual praktik ka për qëllim ta stimuloj frymën e sipërmarrësisë tek të gjithë ata që kanë dëshirë të themelojnë biznes personal, ta zgjoj kreativitetin dhe proaktivitetin, dhe gjithsesi të ndihmoj gjatë ballafaqimit me sfidat të preokupimit tuaj të ardhshëm afarist. Në mënyrë plotësuese, këtyre moduleve u është dhënë edhe Plani për organizimin e kompanisë tuaj, në të cilin janë shpjeguar format juridike të regjistrimit të kompanisë, si dhe të tatimet me të cilët do të ballafaqoheni gjatë kohës së punës tuaj.

Me një punë të kujdesshme me secilin modul, përmes ushtrimeve, udhëzimeve dhe këshillave të udhëhequra nga biznes konsulenti i juaj, ju – si sipërmarrës të ardhshëm me biznes personal – do të keni mundësi të shqyrtoni dhe të definoni disa dimensione shumë të rëndësishme të biznesit. Ato do tua trasojnë rrugën e realizimit të biznesit tuaj në themele të qëndrueshme dhe të sigurta, por do të jenë edhe një udhërrëfyes i qartë për hapat e juaj të ardhshëm dhe për avancimin e punës së ndërmarrjes tuaj.

Ju dëshirojmë sukses në punë dhe plotësimin e ideve tuaja të biznesit!

Programi për Vetëpunësim është pjesë e Planit operativ për shërbime në tregun e punës dhe për masat dhe programet aktive për punësim. Bartës i programit është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa zbatohet nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me mbështetje nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

PROGRAMI PËR VETËPUNËSIM

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR SIPËRMARRËSI DHE ZHVILLIM TË AFTËSIVE TË BIZNESIT

RENDI I DITËS

Dita 1

| Koha | Tema |
|-------------|--|
| 10:00-10:45 | Hapja e trajnimit • Hyrje, qëllimet e seminarit • Ushtrime për t'u njohur Ushtrimi 1: Prezantimi i pjesëmarrësve |
| 10:45-11:00 | Pauzë |
| 11:00-12:45 | Moduli 1: Koncepti i sipërmarrësisë dhe zhvillimit të biznesit • Rëndësia e sipërmarrësisë • Bazat e sipërmarrësisë dhe biznesit • Aftësitë e sipërmarrësisë dhe biznesit Ushtrimi 2: Kompetenca e sipërmarrësit • Karakteristikat e sipërmarrësisë Ushtrimi 3: Karakteristikat e sipërmarrësit Moduli 2: Digjitalizimi i proceseve të biznesit |
| 12:45-13:30 | Pauzë për drekë |
| 13:30-15:00 | • Faktorët e suksesit dhe rregullat e biznesit Ushtrimi 4: Përcaktimi i qëllimeve • Analiza e mjedisit (në përgjithësi) Ushtrimi 5: Identifikimi i njerëzve të cilët do të ndihmojnë në realizimin e qëllimeve |
| 15:00-15:15 | Pauzë |
| 15:15-16:15 | Sublimimi i informacioneve nga dita e parë dhe udhëzimet për ditën e dytë |

Dita 2

| Koha | Tema |
|-------------|--|
| 09:00-09:45 | • Moduli 3: Aftësi dhe mekanizma për planifikimin e biznesit • Gjenerimi i idesë së biznesit personal |
| 09:45-10:00 | Pauzë |
| 10:00-11:45 | • Fjalim i sipërmarrësit model i suksesshëm • Shkëmbimi i përvojave |
| 11:45-12:30 | Pauzë për drekë |
| 12:30-14:00 | • SWOT, çka është analiza SWOT • Anët e forta, të dobëta, mundësitë, kërcënimet • Aplikimi i mekanizmit SWOT Ushtrimi 8: SWOT i IB • Hyrje në planifikimin e Biznesit |
| 14:00-14:15 | Pauzë |
| 14:15-15:30 | • Hyrje në planin e marketingut • Prezantimi i planit të marketingut (përkufizimi i nocioneve kryesore) Drejtime për të menduar dhe formularë për pjesën e ardhshme të trajnimit (prodhimi, konkurrenca, financat) |

Dita 3

| Koha | Tema |
|-------------|---|
| 09:00-10:30 | Moduli 4: Pani i marketingut • Hyrje në Planin e marketingut – përsëritje e shkurtër • Prezantimi i formularit për idenë e biznesit • Analiza e tregut Ushtrimi 9: Përshkrimi i prodhimit • Vlerësimi i kërkesës, promovimi i biznesit • Formimi i çmimit të prodhimit Ushtrimi 10: Profili i blerësit |
| 10:30-10:45 | Pauzë |
| 10:45-11:45 | • Tregu dhe kërkesa • Promovimi • Konkurrenca Ushtrimi 11: Analiza e konkurrencës |
| 11:45-12:30 | Pauzë për drekë |

| | |
|-------------|---|
| 12:30-14:00 | Moduli 5: Shitja <ul style="list-style-type: none"> • Shitja – fillimi i biznesit, Llojet e shitjes • Hapat kryesorë në procesin e shitjes direkte • Parashikimi i shitjes – bazat Ushtrimi 12: Parashikimi i shitjes – përllogaritja e të ardhurave |
| 14:00-14:15 | Pauzë |
| 14:15-15:30 | Ushtrimi 12: Parashikimi i shitjes – përllogaritja e të ardhurave Moduli 5: Plani i prodhimit (për tregun e vendit) <ul style="list-style-type: none"> • Ushtrimi 13: Plani i prodhimit |

Dita 4

| Koha | Tema |
|-------------|--|
| 09:00-09:45 | Moduli 7: Financat <ul style="list-style-type: none"> • Plane dhe raporte financiare Ushtrimi 14: Përllogaritja e shpenzimeve <ul style="list-style-type: none"> • Profitabiliteti • Pragu i rentabilitetit Ushtrimi 15: Pragu i rentabilitetit |
| 09:45-10:00 | Pauzë |
| 10:00-11:45 | <ul style="list-style-type: none"> • Moduli 8: Plani investues Ushtrimi 16: Plani investues <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi dhe menaxhmenti i kompanisë (drejtori, themeluesi, ushtruesi i veprimtarisë, bashkëpunëtorë të jashtëm...) • Format juridike të biznesit, regjistrimi i personit juridik Ushtrimi 17: Plani i organizimit dhe menaxhmentit <ul style="list-style-type: none"> • Tatimimi |
| 11:45-12:30 | Pauzë |
| 12:30-14:00 | <ul style="list-style-type: none"> • Finalizimi i formularit për idenë e biznesit, ligjërata për IB dhe për planin e marketingut |
| 14:00-14:15 | Pauzë |
| 14:15-15:30 | Përfundimi i trajnimit |

FILLIMI I BIZNESIT PERSONAL

Biznesi i mirë "start-up" fillon çdoherë me ide të mirë, megjithatë ide e mirë vetvetiu nuk nënkupton edhe biznes të mirë. Në momentin kur do të ndërliiden, përkatësisht kur ideja me sukses do të shndërrohet në aksion, mund të thuhet se jeni SIPËRMARRËS.

Nga posedimi i idesë e deri në themelimin e biznesit personal duhet të kalohet një proces, i cili do t'u përgjigjet pyetjeve si vijojnë:

1. A jeni të gatshëm të jetoni si sipërmarrës?

Fillimi i biznesit personal e nënkupton edhe ndryshimin e stilit të jetës.

2. A është e realizueshme ideja juaj, a ekzistojnë blerës?

Duhet të bëhet analizë e tregut në mënyrë që të përcaktohet nëse prodhimi/shërbimi juaj ka blerës potencial, dhe nëse ka, a janë ata të gatshëm të paguajnë për prodhimin/shërbimin e atillë.

3. A është mjaftueshëm i madh tregu ekzistues?

Duhet të analizohet konkurrenca, përkatësisht duhet të vlerësohet se a ekzistojnë shanse reale që prodhimi/shërbimi juaj të ballafaqohet me sukses me konkurrencën.

4. A posedoni pajisje/vegla të veçanta dhe kushte hapësinore?

Duhet të vlerësohet nëse pajisja/veglat ekzistuese janë adekuate, përkatësisht pajisja e këtillë a është lehtësisht e arritshme nëse nuk e posedoni, dhe a janë përkatëse kushtet hapësinore?

5. A ju nevojiten resurse njerëzore?

Duhet të përcaktohet se menaxhimi i biznesit a ka nevojë për punësime plotësuese dhe cili profil i të punësuarve nevojitet. Profili i këtillë a është i arritshëm? Nëse jo, a ka mundësi të trajnohen të punësuarit?

Para fillimit të aktiviteteve, rekomandohet të shfrytëzohet mbështetje nga ekspertë për hartimin e detajuar të planit të biznesit.

Shumica e njerëzve mbivlerësohen në lidhje me atë se sa mund të realizojnë për një vit, dhe nënvlerësohen në lidhje me atë se sa mund të realizojnë për dhjetë vjet.
Bill Gates
Microsoft™

Punët e mëdha në biznes asnjëherë nuk janë rezultat të një personi, ato realizohen përmes punës ekipore
Steve Jobs
Apple™

Unë krijoj

Unë jetoj me pasionin tim

Unë ndërmarr rrezik

UNË JAM SIPËRMARRËS

Hyrje

Hapja e trajnimit

- Përfaqësues nga Qendra për Punësim
- Hyrje në Programin Vetëpunësimi
- Prezantimi i trajnuesve

Rregullat themelore të trajnimit

- Ruajeni frymën e dialogut – respektoni mendimet e të tjerëve
- Të fillojmë dhe të përfundojmë në kohë
- Shtroni haptas pyetje dhe përgjigjuni pyetjes – interaksion i ndërsjellë
- Shkyçni telefonat e juaj celular

Qëllimet e trajnimit

1. Të kuptohet sipërmarrësia dhe biznes - planifikimi
2. Teknikat dhe aftësitë e planifikimit dhe menaxhimit të biznesit personal
3. Mbështetje për definimin dhe zhvillimin e idesë së biznesit
4. Përgatitje për mbështetje të mëtutjeshme mentoriale për hartimin e planit të biznesit dhe hapjen e firmës

Çka është vetëpunësimi?

- Vetëpunësimi është gatishmëria e individit të ndërmerr përgjegjësi për menaxhimin e biznesit personal (krijimi dhe ofrimi i prodhimeve/shërbimeve që do t'i shkëmbej me të tjerët).
- Biznesi nënkupton njerëz, komunikim, shitje, blerje, inovacione, krijim, prodhim dhe shumëçka tjetër.

*Njerëzit janë baza e Biznesit

*Paratë i vënë në lëvizje Njerëzit

- Si të menaxhohet biznesi? Si të bëhesh sipërmarrës?

USHTRIMI 1: Njoftimi me pjesëmarrësit e tjerë


Hapi 1: Secili nga pjesëmarrësit prezantohet individualisht

- Emri dhe mbiemri
- Përshkrim i shkurtër i idesë së biznesit
- Njohuri dhe përvoja të cilat i posedon
- Pritshmëri nga programi

Rezultati:

- Pjesëmarrësi e tërheq vëmendjen e pjesëmarrësve të tjerë dhe mendon për ata
- Pjesëmarrësi futet në procesin e identifikimit të blerësve dhe klientëve të biznesit të tij





MODULI 1

Sipërmarrësia

MODULI 1: SIPËRMARRËSIA

Jetojmë në një kohë të ndryshimeve shumë të shpejta sociale, ekonomike, politike, kulturore dhe teknologjike, kohë e cila pamëshirshëm i shkel të gjithë ata të cilët nuk janë të gatshëm t'i ndjekin këto hapa. Sfidat me të cilat ballafaqohet bota e sotme, padyshim se e sfidojnë zhvillimin, megjithatë çdoherë do të mbetet e hapur çështja e ndjekjes së tendencës.

Kështu, edhe në shoqërinë tonë gjendemi në një periudhë kur sipërmarrësia dhe sipërmarrësi janë objekt të interesimit të rritur. Gjithnjë e më shumë rritet numri i njerëzve të cilët e dëshirojnë frymën e sipërmarrësisë dhe idenë për t'i realizuar ato në realitet si pronarë dhe themelues të ndërmarrjeve të tyre. Krijimi i ekonomisë konkurrense dhe të integruar, të bazuar në dije dhe inovacione është kusht për stabilitet makroekonomik, rritje të shpejtë ekonomike dhe punësime të reja. Për themelimin e bizneseve të vegjël, rol të rëndësishëm ka personi, sipërmarrësi, përkatësisht individi i cili ka ide dhe i cili është i gatshëm të ndërmer rrezik për ta realizuar të njëjtën.

Për këtë shkak, nxitja e frymës së sipërmarrësisë është më se e nevojshme në stimulimin e vetëpunësimit dhe zhvillimit të biznesit personal.

Të posedohet një biznes personal, në të vërtetë do të thotë të mendohet seriozisht dhe me përgjegjësi, si dhe ta krijoj ardhmërinë e vet, ardhmërinë e familjes dhe mjedisit të tij. Aktualisht, ky është njëri nga motivet e ranguar në nivelin më të lartë për menaxhim me biznesin personal.

Nocioni sipërmarrësi buron nga fjala franceze "entreprise", që do të thotë ndërmarrje.

Në praktikë sipërmarrësia përkufizohet si "proces dinamik dhe social ku individët vet, ose në bashkëpunim me të tjerë, identifikojnë mundësi për inovacione dhe punojnë në drejtim të transformimit të ideve në aktivitete praktike në raport me kontekstin social, kulturor dhe ekonomik".

Procesi i fillimit të aktivitetit afarist quhet sipërmarrësi. Si edhe çdo proces tjetër, vendimi për fillimin e aktivitetit sipërmarrës përfshin lëvizjen nga diçka drejt diçkaje – lëvizje. Nocioni "sipërmarrësi" ka domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm, varësisht nga perspektiva konceptuale e tyre. Pavarësisht dallimeve, ekzistojnë edhe disa aspekte të përbashkëta siç janë ndërmarrja e rrezikut, kreativiteti, pavarësia dhe motivimi/shpërblimi.

Sipërmarrës

Edhe pse një numër i konsiderueshëm i personave janë sipërmarrës të lindur, zhvillimi i sjelljes sipërmarrëse mund të inkurajohet. Sipërmarrësi duhet ta zbuloj, vlerësoj dhe ta zhvilloj mundësinë pavarësisht rezistencës së faktorëve të mjedisit.

Aftësia që të parashikohen disa rrethana dhe mundësi të caktuara të suksesit, pranimi i rrezikut i cili mund të shkaktohet, inkorporimi i inovacioneve dhe mësimi i vazhdueshëm, janë aftësitë elementare të cilat është e nevojshme t'i posedoj çdo sipërmarrës. Sipërmarrësi i mirëfilltë mund ta perceptoj mundësinë e vërtetë në momentin e vërtetë gjatë ngjarjeve në treg.

Karakteristikat e sipërmarrësit

"Secili mund të jetë sipërmarrës. Nuk ekzistojnë kufij në lidhje me perceptimin, ajo që është e rëndësishme është të identifikohet mundësia." - Kirnez

Dëshira e të qenit sipërmarrës ndoshta është e madhe tek një numër i madh i njerëzve, megjithatë duhet t'i përkushtohet vëmendje kësaj si vijon:

- **Qëndrime:** Sipërmarrësi i suksesshëm çdoherë duhet të fokusohet në qëndrime pozitive. Punëtori i rëndomtë pret që punët të ndodhin, pret instruksione, pret që dikush tjetër t'i zgjidhë problemet, ndërsa sipërmarrësi vepron në drejtim që punët të ndodhin, ofron instruksione të qarta, situatat i merr në duar të veta, në mënyrë që t'i zgjidhë të gjitha pengesat ose problemet e mundshme të shfaqura.
- **Përgjegjësitë:** Suksesi në sipërmarrësi, nuk e nënkupton vetëm planin e biznesit të suksesshëm, ose menaxhimin e mirë me paratë. Nëse diçka nuk shkon si duhet me biznesin nuk duhet të akuzohet tregu, gjendja ekonomike në vend, konkurrenca ose mjedisi. Sipërmarrësi i mirë duhet ta merr kontrollin në duart e tij, ta merr përgjegjësinë për gabimet dhe të mësoj prej tyre.
- **Puna ekipore:** Duke iu ndihmuar të tjerëve i ndihmoni vetvetes. Komunikimi i ndërsjellë me të punësuarit dhe partnerët shpie në përfundimin e frymës ekipore dhe krijimin e ekipit fitues.
- **Mësimi i vazhdueshëm:** Askush nuk është i përsosur! Çdoherë duhet të jeni të gatshëm të mbindërtoheni. Mbindërtimi përmes mësimit formal ose joformal, nuk është vetëm për të punësuarit, por edhe për ju si sipërmarrës.

Këto janë disa nga aftësitë dhe karakteristikat të cilat duhet t'i posedoj një sipërmarrës i suksesshëm:

| | |
|--------------------------|------------------------------|
| Guximi | Qëndrueshmëria |
| Orientimi kah aksioni | Mbështetja në forcat vetjake |
| Orientimi kah suksesi | Pavarësia |
| Perceptimi i mundësive | Vetëbesimi |
| Përcaktimi i qëllimit | Vetë-respektimi |
| Perspektiva shumëvjeçare | Zgjidhja e problemeve |
| Motivimi dhe energjia | Toleranca... |

Sipërmarrësi i suksesshëm beson në vetvete, kjo do të thotë se posedon vetëbesim, beson se arritjet dhe suksesi varen nga angazhimi i tij dhe ndikimi i tij mbi rezultatin përfundimtar.

Procesi i sipërmarrësisë përfshinë katër hapa:

| | |
|---------------|---|
| Hapi 1 | Vendimi për t'u bërë sipërmarrës |
| Hapi 2 | Zhvillimi i ideve të suksesshme të biznesit |
| Hapi 3 | Lëvizja nga ideja deri në fillimin e biznesit |
| Hapi 4 | Menaxhimi dhe zhvillimi i biznesit |



Koncepti i sipërmarrësisë

Mënyra e të menduarit dhe sjelljes; (art, shkencë, aftësi) për identifikimin e mundësive.

Sipërmarrësia (si disiplinë) ka të bëjë me aftësinë e individit që idetë t'i shndërroj në vepra.

Kjo e përfshinë kreativitetin, inovacionin dhe ndërmarrjen e rreziqeve, si dhe aftësinë e planifikimit dhe administrimit me projekte për arritjen e qëllimeve.

Rëndësia e sipërmarrësisë

Sipërmarrësia është promotori kryesor i inovacionit, konkurrencës dhe zhvillimit të ekonomive nacionale.

Sipërmarrësia në biznes e nënkupton fillimin dhe realizimin e biznes ideve dhe të inovacioneve, përkatësisht fillimin dhe menaxhimin e biznesit, me qëllim të realizimit të profitit.

Sipërmarrësi është person i përgatitur që ta ndërmarr rrezikun e rezultatit të aktivitetit të kryer ekonomik

SHNDËRRIMI I IDEVE NË VEPËR

Procesi i sipërmarrësisë

| | | | | | |
|----------------|----------|--------------------------|----------------|-----------|---------------|
| 1. Sipërmarrës | 2. Ideja | 3. Prodhimi/ Shërbimi | 4. Të punësuar | 5. Blerës | 6. Ndërmarrje |
|----------------|----------|--------------------------|----------------|-----------|---------------|

Bazat e sipërmarrësisë

- Sipërmarrësi
- Ideja e biznesit me produktin për zgjidhjen e problemeve dhe jetë më të mirë të njerëzve të tjerë
- Ndërmarrja dhe resurset
- Qasja dhe komunikimi me njerëzit
- Mësim gjatë gjithë jetës – Sipërmarrësia mund të mësohet.

Pjesa më e madhe e asaj që dëgjojmë për sipërmarrësinë është e gabuar. Nuk është magji; kjo nuk është një mister; dhe nuk ka të bëjë fare me gjenet. Kjo është një disiplinë, dhe mund të mësohet si çdo disiplinë tjetër.

Bazat e biznesit

Biznesi nënkupton përpjekje të organizuar nga ana e individit ose grupit të njerëzve, me shfrytëzimin e faktorëve për prodhimtari, të prodhohet dhe të shitet një e mirë dhe një shërbim i caktuar, për kënaqjen e një nevojë të caktuar, me qëllim të realizimit të profitit.

| Faktorë të prodhimit | |
|----------------------|--|
| Puna | resurset njerëzore – aftësitë fizike dhe mendore të njerëzve |
| Kapitali | objektet, makinat, veglat, mjetet financiare, pajisja, mjetet e transportit |
| Vendi | resurset natyrore |
| Sipërmarrësia | resurset njerëzore – aftësia e njeriut për të krijuar, menaxhuar, vendosur, ndërmarrë rrezikun |

Shkaqet e menaxhimit të biznesit të vogël

Bizneset e vegjël janë të rëndësishëm për ekonominë meqë e punësojnë pjesën më të madhe të fuqisë së punës në shtet, janë fleksibil dhe më lehtë u përshtaten nevojave lokale.

Shkaqe për fillimin e biznesit:

- Punësimi
- Fitimi më i madh
- Zot i vetvetes
- Punë fleksibile
- Vetë-konfirmimi dhe shfrytëzimi i talentit dhe aftësive
- Fusha e re për biznes të vogël – biznese të gjelbra

USHTRIMI 2: Kompetenca e sipërmarrësit

| Kompetencat | Niveli i kompetencës | | | |
|--|----------------------|----------------|-------------|-------------------------|
| | Duhet të zhvillohet | Njohuri bazike | Kompetent/e | Njohuri të shkëlqyeshme |
| Kompetencat kryesore të biznesit | | | | |
| Shitja | | | | |
| Prodhimtaria | | | | |
| Kontabiliteti | | | | |
| Financat | | | | |
| Resurset njerëzore | | | | |
| Kompetencat në lidhje me veprimtarinë | | | | |
| Ekspertizë në veprimtari | | | | |
| Aftësitë | | | | |
| Njohja e tregut | | | | |
| Aftësia e detektimit të problemeve | | | | |
| Aftësia e perceptimit të mundësive | | | | |
| Kompetenca në lidhje me resurset | | | | |
| Informacionet për idenë e biznesit | | | | |
| Financimi i biznesit | | | | |
| Hapësira e biznesit | | | | |
| Pajisja dhe makinat | | | | |
| Repromaterialet | | | | |
| Persona për mbështetje | | | | |
| Kompetenca në lidhje me vendosmërinë | | | | |
| Biznesin do ta kem fokus primar | | | | |
| I përgatitur për aksion | | | | |

I përgatitur për aksion

1. I guximshëm (ndërmarrja e aksionit krahas ekzistimit të frikës nga mossauesi)
2. I saktë, i ndershëm, i sinqertë
3. Aktiv
4. I qëndrueshëm, këmbëngulës
5. I suksesshëm
6. Kërkim të mundësive
7. I informuar
8. Komunikues, ndërtimi i rrjetit të kontakteve
9. Sistematik, i organizuar
10. Me vetëbesim
11. Cilësor
12. Planifikues dhe analitik
13. Efikas
14. I parashikueshëm (ndërmarrja e rrezikut të kalkuluar, të parashikuar)

USHTRIMI 3: Shkruani dhe radhitni karakteristikat e sipërmarrësit – karakteristikat tuaja



Faktorë të suksesit – rregullat e biznesit

- Qëllime të qarta (qëllime personale dhe qëllime biznesi)
- Planifikimi i biznesit – ideja e biznesit
- Produkt i vlefshëm – plani i prodhimit
- Organizimi i punës – plani i menaxhmentit dhe organizimit
- Nevojat e blerësve – plani i marketingut
- Të ardhura – procesi i shitjes
- Resurse – plani i investimeve dhe burimi i mjeteve
- Kontrolli i shpenzimeve – plani financiar
- Kontrolli i rreziqeve - analiza SWOT

Formula e suksesit në biznes

Suksesi ose mossauesi në biznes janë rezultat i vendimeve dhe sjelljes së njerëzve

Formula (Dëshira+Ideja) x Njohuri = Sukses!

- Dëshira = çka dua të arrij me përpjekjet ose qëllimet e mia (qëllime personale dhe të biznesit)
- Ideja = drejtimi i lëvizjes që të realizohen dëshirat (qëllimet)
- Njohuri = mjet për lëvizje në drejtimin e zgjedhur (njohuritë më cilësore na çojnë më shpejt në drejtimin e zgjedhur)

Përcaktimi i qëllimeve

- Qëllimet e lëvizin njeriun në drejtim të një gjëje të rëndësishme dhe të vlefshme (dëshirat e individit)
- Qëllimet janë energjia e individit

USHTRIMI 4 : PËRCAKTIMI I QËLLIMEVE

A. MËNYRA E FORMULIMIT TË QËLLIMEVE

1. Fillon me vetën e parë njëjës UNË. Çka dëshiron – të jetë, të bëhet, të ketë
2. Çdoherë folja është në kohën e tashme, bëjë, kam, jam

- Të bëhet/krijohet diçka – Aktivitete që kanë të bëjnë me diçka të rëndësishme
- Dua të bëj.....OSE Unë do të punoj në
- Të ketë diçka – Të posedohet diçka (Shpeshherë të POSEDOSH/TË KESH do të thotë të arrihet një qëllim i caktuar)
- Dua të kem personale ose Dua të kem
- Realizimi i ndryshimeve personale – përcaktimi i standardeve personale gjatë punës, shkathtësitë, statusi

3. Dua të jem.....

4. Qëllimet mund të jenë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Qëllimet afatshkurtra janë deri një vit, qëllimet afatmesme janë deri në tre vjet, qëllimet afatgjata janë deri në pesë dhe mbi pesë vjet.

B. PROCESI I PËRCAKTIMIT TË QËLLIMEVE

| | |
|------------------------------|----------------------|
| S psecifik | S pecific |
| M atshëm | M esurable |
| A rritshëm | A chievable |
| R ealist | R ealistic |
| Të përcaktuar në kohë | T ime bounded |

1. Specifik: Të dihet saktësisht çka dëshironi (kam firmë, shes në, jam pronar i, fitoj para....)
2. Të matshme: atë që njeriu mund ta masë, mundet edhe ta kontrolloj (firmë e regjistruar me dy të punësuar, me të ardhura prej 50.000 euro... shes 2000 copë prodhime/në nivel vjetor..... fitoj 1.000 euro në muaj... punoj me 20 klientë në muaj...)
3. Të arritshme: këtë dikush tjetër tanimë e ka bërë.... këtë e kam bërë paraprakisht, ekzistojnë mundësi konkrete që më shkojnë në favor...
4. Reale: Mund të arrihen me angazhim personal...
5. Të përcaktuar në kohë: saktësisht deri në cilën datë do të realizohet.

V. KLASIFIKIMI I QËLLIMEVE

1. Familje, shtëpi
2. Para dhe krijimi i pronës
3. Karriera, puna, profesioni, përsosja personale,
4. Marrëdhëniet shoqërore, ndërnyerëzore (kulturore, sociale, politike, etj.).
5. Hobi, kënaqësia dhe rekreacioni.

PËRCAKTIMI I QËLLIMEVE

Qëllimet duhet të definohen mirë, të jenë të matshme, me afat saktësisht të përcaktuar, të realizueshme, me një fjalë duhet të përcaktohen në mënyrën SMART (të MENÇUR)

| |
|--|
| <p>ÇKA DËSHIROJ TË ARRIJ NË BIZNES NË TRE VITET E PARA TË PUNËS</p> <p>1. Shkruani një qëllim afatmesëm, i cili duhet të realizohet në tre vitet e para: (shfrytëzo SMART)</p> <p>dhe dy qëllime afatshkurtra, të cilat duhet të realizohen në vitin e parë:</p> <p>a.</p> <p>b.</p> |
| <p>2. Çka më nevojitet për realizimin e qëllimeve të përcaktuara:</p> |
| <p>3. Si do ta perceptoni ose do ta matni progresin Tuaj? Si do ta dini se e keni arritur qëllimin?</p> |
| <p>4. Si do ta perceptoni ose matni progresin Tuaj: Si do ta dini se e keni arritur qëllimin?</p> <p>Nga aspekti personal:</p> <p>Mjedisi shoqëror:</p> |



MODULI 2 Digjitalizimi i proceseve të biznesit

MODULI 2: DIGJITALIZIMI I PROCESVEVE TË BIZNESIT

Epoka digjitale e ndryshoi mënyrën në të cilën jetojmë dhe punojmë. Mënyra tradicionale e kryerjes së punëve tashmë nuk është më efektive. Prandaj bizneset duhet të përdoren mjete për digjitalizim të operacioneve të biznesit me qëllim për të mbetur konkurrentë në treg duke implementuar praktikën më të mirë për digjitalizim.

Nëse biznesi dëshiron të ketë sukses në ekonominë e sotme digjitale, atëherë atij i nevojiten mjete digjitale gjatë realizimit të operacioneve të përditshme të biznesit.

Mjetet digjitale na sigurojnë mënyrë të re të komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Ato na ofrojnë qasje në të dhënat të cilat kanë qenë të disponueshme më parë, dhe na mundësojnë përpunim të informacioneve me ritëm shumë më të shpejtë. Megjithatë, nëse nuk i përdorim këto mjete në mënyrë efektive, atëherë do të jemi më pak efikas dhe efektiv në punën tonë.

Cilat janë mjetet për digjitalizim?

Mjetet për digjitalizim janë softueri dhe teknologjitë që u ndihmojnë bizneseve për t'i digjitalizuar operacionet dhe proceset e tyre afariste me qëllim të fundit për ta përmirësuar efikasitetin, për t'i optimizuar bashkëveprimet digjitale me klientët dhe partnerët dhe ta modernizojnë modelin e tyre të biznesit.

Këto vegla aplikohen në mënyrë të rregullt, ato mund t'u ndihmojnë bizneseve gjatë digjitalizimit të operacioneve të biznesit.

Pse janë të rëndësishme mjetet për digjitalizim?

Mjetet për digjitalizim bëhen gjithnjë më të rëndësishme për bizneset sepse ato sigurojnë mënyrë të re për komunikim, janë të lehtë për shfrytëzim dhe i lehtësojnë operacionet e përditshme të biznesit.

Si përparësi kryesore të mjeteve për transformim mund të thuhet se janë:

1. E lehtësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin: Mjetet digjitale mund t'u ndihmojnë bizneseve që të komunikojnë më mirë dhe të bashkëpunojnë kryesisht me këto të punësuar, e pastaj edhe me komitentët dhe blerësit e fundit.
2. E lehtësojnë ruajtjen e të dhënave dhe qarkullimin e informacioneve: këto mjete mund të ruajnë të dhëna në mënyrë më të sigurt se metodat tradicionale. Migrimi në "cloud" u ndihmon bizneseve në sigurimin e të dhënave të tyre,

njëkohësisht duke lejuar qasje në të dhënat në çdo kohë dhe në çdo vend.

3. E rrisin produktivitetin: Këto mjete mund t'i bëjnë bizneset më produktivë duke i automatizuar proceset e biznesit.
4. E përmirësojnë efikasitetin: mjeti digjital mund t'i bëjë punët më efikase duke siguruar mënyrë optimale për finalizimin e operacioneve të biznesit me shpenzime më të vogla dhe më pak kohë të harxhuar.

Cilët janë mjetet më të mira për transformim digjita?

1. Mjetet për komunikim

Mjetet e komunikimit digjital janë teknologji që përdoren për komunikim me tjerët.

Këto platforma mundësojnë mesazhe të çastit, thirrje me zë dhe video thirrje ndërmjet përdoruesve. Shembulli më i njohur për këtë janë platformat për bisedë si Google meet, Zoom, Microsoft Teams, Whatsapp ose Skype.

Këto mjete digjitale kanë luajtur rol kryesor veçanërisht në pandeminë Covid-19 ku prej të gjithë neve kërkohet të punojmë nga shtëpia. Pa ato nuk mund të komunikojmë me kolegët tanë dhe të kryejmë detyrë ose projekt të përbashkët

2. Softueri për menaxhim me dokumentet

Digjitalizimi i dokumenteve duhet të jetë hapi i parë në të cilëndo strategji për digjitalizim.

Bizneset nuk mund të digjitalizohen pa kaluar nga dokumente të letrës në zyre pa letër. Menaxhimi me dokumente ose document management software (DMS) është softueri më i mirë i cili ndihmon në digjitalizimin. Aftësitë e këtyre mjeteve mund të ndihmojnë të reduktohet koha e nevojshme për gjetjen e informacioneve dhe dokumenteve, kontroll të versioneve të dokumenteve dhe eliminim të humbjes së dokumenteve.

Ato mund të përdoren për ruajtje, organizim dhe marrje të dokumenteve. Me rëndësi është që çdo organizatë të ketë DMS sepse kjo ndihmon në mënyrat në vijim:

- Ndihmon në ruajtjen e sigurt të të gjitha dokumenteve
- I organizon të gjitha dokumentet
- Jep pasqyrë të qartë mbi detyrat e punonjësve
- I kthen dokumentet kur është e nevojshme, përkatësisht kur nuk janë të punuara plotësisht

3. Mjete për automatizim të proceseve afariste

Zgjedhja e mjeteve të duhura për automatizimin e proceseve të biznesit është me rëndësi kryesore për një biznes. Bizneset janë vazhdimisht në kërkim të mjeteve teknologjike për t'i ndihmuar ata të drejtojnë operacionet e tyre të biznesit në mënyrë efikase në garën e sotme të digjitalizimit.

Mjetet e automatizimit të proceseve të biznesit janë programe softuerike që automatizojnë dhe i orientojnë proceset e biznesit. Ato mund të përdoren për të rritur efikasitetin, për të ulur shpenzimet dhe për të përmirësuar shërbimin ndaj klientëve.

Punonjësit nuk duhet të kryejnë më manualisht detyrat e tyre. Të disponueshme janë mjete për digjitalizim të cilat do ta automatizojnë futjen e të dhënave ose çdo operacion tjetër biznesi të përsëritur, duke liruar resurse për operacione më të rëndësishme.

4. Mjete për CRM

Softueri i menaxhimit të marrëdhënieve me klientët (CRM) është një lloj softueri që ndihmon bizneset të menaxhojnë dhe organizojnë bashkëveprimet me klientët. Këto bashkëveprime janë zakonisht në formën e emailëve, telefonatave, bisedave në internet dhe mesazheve në mediat sociale.

CRM-të u ndihmojnë bizneseve të kuptojnë më mirë klientët e tyre dhe t'i bëjnë ata më besnikë. Mjetet CRM gjithashtu ndihmojnë në mbajtjen e klientëve duke ofruar shërbime ndaj klientëve dhe oferta të personalizuar.

Bizneset i përdorin këto mjete për të krijuar një pasqyrë më të mirë për klientët e tyre. Kjo përfshin të gjitha bashkëveprimet që i ka klienti me biznesin, siç janë telefonatat, emailët, mesazhet dhe postimet në rrjetet sociale. Të dhënat e mbledhura përdoren më pas për të përmirësuar produktin ose shërbimin për klientët dhe për të zhvilluar produkte ose shërbime për klientët e rinj.

Softueri i ndihmon bizneset në mënyra të ndryshme pasi i ndihmon ata në marketingun duke ofruar njohuri të detajuara se çfarë u pëlqejnë ose nuk u pëlqejnë klientëve në lidhje me produktet ose shërbimet e tyre, por gjithashtu i ndihmon ata në shitje duke ofruar një pasqyrë se cilat marrëveshje me gjasë do të mbyllën së shpejti.

5- Mjete për nënshkrim elektronik

Mjet për nënshkrim elektronik është softueri i cili ofron mundësi që të nënshkruhet në mënyrë elektronike një dokument

dhe të verifikohet. Ky mjet kryesisht përdoret në bizneset për transformim digjital.

Disa prej përfitimeve nga shfrytëzimi i mjetit për nënshkrim elektronik janë:

- Kjo ndihmon të reduktohet koha e nevojshme për përpunim të dokumenteve dhe kontrastave
- Ndihmon në reduktimin e harxhimit të letrës
- Ndihmon në automatizimin e procesit dhe menaxhimin me rrjedhën e punës
- Ndihmon në reduktimin e gabimeve njerëzore.

6-Mjeti për menaxhim me projekte

Një nga mjetet më të rëndësishme të transformimit digjital të cilin duhet ta pranojnë të gjitha bizneset është mjeti digjital i menaxhimit të projektit.

Mjetet digjitale të menaxhimit të projekteve janë shtylla e çdo transformimi digjital. Janë ato që ndihmojnë bizneset të menaxhojnë më lehtë ekipet e projektit, të gjenerojnë raporte, t'i monitorojnë projektet aktuale dhe më shumë.

7- Mjete për menaxhim me njohuritë

Mjetet për menaxhim të njohurive luajnë rol të rëndësishëm në transformimin digjital të bizneseve. Ata i ndihmojnë ata të ruajnë, organizojnë dhe ndajnë informacionin në mënyrë më efikase.

Softueri për menaxhim të njohurive i ndihmon bizneset të ruajnë dhe ndajnë njohuritë me punonjësit, partnerët dhe klientët. Ato janë gjithashtu të dobishme për punonjësit që duan të kenë qasje të shpejtë në njohuritë që u nevojiten.

Shënime:



MODULI 3
Aftësitë dhe mekanizmat
për planifikimin e biznesit

MODULI 3: AFTËSITË DHE MEKANIZMAT PËR PLANIFIKIMIN E BIZNESIT

ΓPromotor kryesor i ekonomisë nacionale në çdo vend janë ndërmarrjet private. Ato janë një nga segmentet kryesorë gjatë krijimit të vendeve të reja të punës, rritjes së eksportit, krijimit të produkteve dhe shërbimeve inovative, promovimit më të madh të prodhimeve vendase në tregjet e huaj, etj.

Ekzistojnë katër lloje të ndërmarrjeve sipas madhësisë së tyre, numrit të të punësuarve dhe të ardhurave vjetore, edhe atë: Mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha.

Klasifikimi i ndërmarrjeve

| | BE definicioni për ndërmarrjet | Ligji për shoqëri tregtare (2004) |
|----------|--|--|
| Mikro | Deri në 10 të punësuar | Deri në 10 të punësuar |
| | Qarkullim vjetor më i ulët ose i barabartë me 2 milion EUR | Qarkullim vjetor më i ulët se 50,000 EUR |
| | Bilanci i gjendjes më i ulët ose i barabartë me 2 milionë EUR | Jo më shumë se 80% e të ardhurave bruto të vijë nga një klient |
| Të vogla | Deri 50 të punësuar | Deri 50 të punësuar |
| | Qarkullim vjetor më i ulët ose i barabartë me 10 milionë EU | Qarkullim vjetor më i ulët se 2 milionë EUR |
| Të mesme | Bilanci i gjendjes më i ulët ose i barabartë me 10 milionë EUR | Bilanci i gjendjes më i ulët se 2 milionë EUR |
| | Deri 250 të punësuar | Deri 250 të punësuar |
| | Qarkullim vjetor më i ulët ose i barabartë me 50 milionë EUR | Qarkullim vjetor më i ulët ose 10 milionë EUR |
| Të mëdha | Bilanci i gjendjes më i ulët ose i barabartë me 43 milionë EUR | Bilanci i gjendjes më i ulët ose i barabartë me 11 milionë EUR |
| | Të gjitha të tjerat të cilat nuk bëjnë pjesë në njërin nga klasifikimet e lartpërmendura | Të gjitha të tjerat të cilat nuk bëjnë pjesë në njërin nga klasifikimet e lartpërmendura |

Thuaja se në të gjitha vendet e botës numri i NVM është midis 95% dhe 99% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve private. Kështu, edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) janë tip dominant i ndërmarrjeve dhe përfaqësojnë 99,64% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve ekzistuese, ndërkaq me këtë konfirmohen si pjesëmarrës të rëndësishëm në ekonominë si tërësi dhe si kreatorë të rëndësishëm të prodhimit shoqëror.

Ato absorbojnë rreth 80% të fuqisë së punës në tregun e punës, numri më i madh i kompanive kanë 1-9 të punësuar, me çka kanë një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e papunësisë. Sipas sektorëve, rreth 50% janë në sektorin e shërbimeve (tregti, zeytari, sektori shërbyes), 30% në industri dhe 20% në sektorin e bujqësisë.

Bizneset e vegjël janë të rëndësishëm për ekonominë meqë përveç asaj që punësojnë janë më fleksibil dhe më lehtë u përshtaten ndryshimeve të kërkesës së tregut, më shpejtë mund t'u përgjigjen nevojave lokale, janë inovativë dhe sigurojnë konkurrencë.

Çdo biznes fillon si biznes i vogël, në pronësi të një personi ose të një grupi të vogël të partnerëve, ku menaxhmenti është i pavarur, veprojnë në nivel lokal, me mjete të kufizuara dhe me numër relativisht më të vogël të të punësuarve.

Përgjithësisht në ekonomi, por edhe përmes Programit për vetëpunësim, interesim më të madh për bizneset e vegjël është evidentuar në këto fusha:

I. **PRODHIM** – bukë dhe nënprodukte të miellit (bukëpjekës), këpucë, prodhime tekstili, mobile, qumësht dhe nënprodukte të qumështit, pije joalkoolike, pjesë këmbimi për makina, ushqim, drithëra, ...

II. **TREGTI** – barnatore, dyqane kasapi, butiqe (dyqane për këpucë, prodhime tekstili, lodra...), markete (produkte ushqimore etj.), librari, stoli, kozmetikë,...

III. **SHËRBIME** – institucione private shëndetësore (mjek të përgjithshëm, stomatologë, specialistë, medicina e punës), avokatë, servis për automjete, motoçikleta dhe autobusë, sallon parukerie dhe kozmetike, lavazhe të automjeteve, qilimave dhe ngjashëm, pastrim kimik, kapacitete akomoduese dhe objekte hotelerie, teknologji të informacionit, taksistë ose lloje të tjera të transportit, etj.

IV. **NDËRTIMTARI** – Punëtori marangozi, ndërmarrje për punë elektrike, ujësjellës, kanalizim, instalime për ngrohje dhe klimatizim, murator, bojaxhi, fasada dhe shumë të tjera.



Ku mund të gjeni diçka plotësuese për idenë Tuaj të biznesit?

- Në mjedisin tuaj
- Në hobin tuaj
- Në punën tuaj aktuale ose në punën e mëparshme
- Në tendencat e tregut
- Në panaire
- Në revista
- Në inovacione
- Në universitete dhe në institucione të tjera
- Në bisedë me familjarët dhe miqtë tuaj

Analiza SWOT

- Strength – anët e forta dhe përparësitë
- Weaknesses - dobësitë
- Opportunities - mundësitë
- Threats - kërcënimet

Vlerësimi i ideve të biznesit

Analiza SWOT e idesë së zgjedhur të biznesit

Anët e forta

Cilat njohuri i posedoni?
 Sa dhe çfarë përvojë keni?
 Cilat aftësi i posedoni?
 Cili është hobi juaj?
 Sa mjete keni në dispozicion, pajisje dhe vegla?
 Emblematik në treg, numër i caktuar i klientëve

Mundësitë

Cilat janë ndryshimet në shoqëri të cilat krijojnë mundësi për biznese të reja?
 Çka bëjnë sipërmarrësit e tjerë?
 Pjesëmarrje në tenderë?
 Ngjarje në afërsinë tuaj?
 Programe për mbështetjen e bizneseve?
 Zbatimi i teknologjive të reja?

Anët e dobëta

Cilat prej anëve tuaja të dobëta do t'u pengonin në idetë e përzgjedhura të biznesit?
 Nuk keni përvojë të mjaftueshme?
 Nuk keni financa të mjaftueshme?
 Nuk keni pajisje dhe vegla përkatëse?
 Nuk keni njohuri dhe kompetenca të mjaftueshme?
 Përpiquni t'i tejkaloni!

Kërcënime

A ka në mjedisin tuaj rreziqe dhe kërcënime?
 Çka mund ta dëmtoj idenë?
 Politikat e shtetit, rregullativa të reja, tatime?
 Faktorë demografikë?



MODULI 4

Plani i marketingut

MODULI 4: PLANI I MARKETINGUT

Marketingu është proces i dy-kahshëm, në njërën anë jeni Ju dhe oferta Juaj, ndërsa në anën tjetër tregu dhe kërkesa e tij. Plani i marketingut duhet t'i përmbaj elementët si vijojnë:

I. Përshkrim i prodhimit/ shërbimit – bëni një përshkrim të shkurtër të prodhimit/shërbimit, formës së tij, ngjyrës, madhësisë, numrit të prodhimeve/shërbimeve që i ofroni. A është i ri prodhimi/shërbimi apo tanimë ekziston në treg.

II. Krahasim i prodhimit/shërbimit me prodhimet/shërbimet e konkurrencës – theksoni se çka është ajo që prodhimin/shërbimin tuaj e bën të veçantë në treg. A bën dallim të konsiderueshëm çmimi në shitje? Cila është përparësia konkurrense e juaj?

III. Lokacioni i biznesit – Vend-pozita është me rëndësi thelbësore dhe njëri nga faktorët kryesor për sukses dhe zhvillim të biznesit. Gjithashtu, faktorë të rëndësishëm të cilët duhet të merren parasysh në lidhje me lokacionin janë: afërsia e konsumatorëve, afërsia e furnizuesve, akses në linjat e transportit dhe infrastrukturë, qasje në fuqinë e kualifikuar dhe të lirë e punës, afërsia e bizneseve të ngjashme dhe të përafërta.

IV. Zona e tregut – ka të bëjë me atë se cilën zonë gjeografike e mbulon biznesi. Në cilën zonë gjeografike do të pozicionohet biznesi, më së shumti varet nga: natyra e prodhimit/shërbimit; lloji i transportit dhe mënyra e distribuimit, madhësia e tregut në lokacione të ndryshme, prania e konkurrencës së fuqishme në mjedisin e biznesit, gatishmëria juaj për udhëtim, kontakte dhe kanale të njohura të distribuimit.

V. Blerësit kryesorë – Pas përcaktimit të zonës gjeografike, është me rëndësi të përcaktohet target grupi të cilit do t'i shitet prodhimi/shërbimi.

VI. Kërkesa e përgjithshme – ka të bëjë me përcaktimin sa nga prodhimi/shërbimi tanimë shitet në treg.

VII. Pjesëmarrja në treg – ka të bëjë me përcaktimin e pjesëmarrjes në përqindje të biznesit tuaj në treg. Pjesëmarrja e juaj në treg varet shumë nga aftësia juaj që ta shisni prodhimin/shërbimin tuaj nga kontaktet, nga efektiviteti i strategjisë tuaj të marketingut dhe nga mënyra e shitjes së prodhimeve/shërbimeve.

VIII. Parashikimi i shitjes – ka të bëjë me përllogaritjen se sa prodhime/shërbime mund të shisni realisht në nivel mujor gjatë një viti dhe pastaj gjatë pesë viteve të ardhshëm.

IX. Çmimi i shitjes – ekzistojnë tri metoda themelore të përllogaritjes së çmimit të shitjes së prodhimit/shërbimit.

- a. Metoda shpenzime - plus
- b. Metoda komparative
- c. Metoda – çmimi të cilin mund ta duroj tregu

X. Promovimi – promovimi i biznesit është i domosdoshëm dhe shërben që t'i bind blerësit ta blejnë prodhimin/shërbimin tuaj, dhe jo të konkurrentëve tuaj. Çdo biznes i suksesshëm nënkupton edhe promovim të suksesshëm dhe pjesë mirë të parashikuar për promovim.

XI. Strategjia e marketingut – Strategjia e marketingut – përgatitja për strategjinë e marketingut nënkupton planifikim të mirë dhe integrim të strategjisë në lidhje me prodhimin, strategjinë e çmimit, strategjinë e distribuimit dhe strategjinë promovuese.

XII. Shpenzime marketingu – Shpenzime marketingu - nënkupton parashikimin e buxhetit, i cili do t'i përfshijë shpenzimet e promovimit, distribuimit dhe shitjes, si dhe të pagave të njerëzve që shesin.

Internet marketingu

Internet marketingu, gjithashtu i njohur edhe si ueb-marketing, onlajn marketing ose e-marketing, e-marketing për prodhime dhe shërbime në internet.

Interneti, si info-platformë globale interaktive nënkupton edhe një sërë të beneficioneve unike të marketingut.

Në vijim ua prezantojmë disa prej tyre:

- çmimi më i ulët
- përzgjedhje më e mirë
- shërbimi më i mirë
- kushte speciale
- përparësi
- dërgesë e shpejtë

Sipas një numri të madh të ekspertëve të marketingut, pikërisht natyra interaktive e internet-marketingut, si për sigurimin e përgjigjes së çastit nga publiku dhe stimulimin e reaksionit të tyre të kthyeshëm, është cilësi unike e mënyrës së këtyllë të komunikimit. Sipas statistikave të fundit në nivel botërorë, madje 7 prej 10 njerëzve kanë përshtypje më të mirë për brendin nëse shohin ndonjë formë të reklamimit të tij në media të caktuara onlajn.

Nga ana tjetër, internet marketingu i ndërlidh aspektet kreative dhe teknike të internetit, duke e përfshirë dizajnin, zhvillimin, reklamimin dhe shitjen.

Në mënyrë që biznesi juaj të arrij sukses maksimal, çdo biznes duhet të mendoj për kombinimin e marketingut onlajn dhe oflajn, përkatësisht media tradicionale dhe e-media. Varësisht nga buxheti të cilin e posedon çdo biznes në masë të mjaftueshme për marketing të shërbimeve dhe serviseve të veta, miksi i të dy llojeve të mekanizmave të komunikimit do të ndihmoj për identifikimin maksimal dhe ndërtimin e reputacionit të brendit.

Media sociale

Çdo pronar/pronare e biznesit duhet doemos të mendoj për reklamimin e firmës së vet, produktit ose shërbimit të vet përmes mediave sociale. Ekspertët e marketingut digjital tanimë janë unanim në pohimet e tyre se pavarësisht se cilin produkt dëshironi ta shisni, si dhe kujt dëshironi tua ofroni, përdorimi i mediave sociale si mekanizëm i marketingut mund t'ju ndihmojnë që ta rrisni biznesin tuaj.


